

KONVENTA Nr. 111

Mbi diskriminimin ne fushen e punësimit dhe te profesionit

Data e hyrjes ne fuqi: më 15 qeshor 1960,

Konferenca e Pergjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, i cili u mbledh më 4 qeshor 1958, në Sesionin e saj te 42-të,

Pasi vendosi të miratojë një sërë propozimesh lidhur me diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesionit, çështje kjo që përbën piken e katërt te rendit të ditës të Sesionit,

Pasi vendosi që këto propozime të merrnin formën e një Konvente ndërkombëtare.

Duke patur parasysh se Deklarata e Filadelfias pohon që të gjitha qëniet njerëzore, ciladoqoftë raca e tyre, besimi ose seksi i tyre, kanë të drejtë ta thellojnë përparimin e tyre material dhe zhvillimin shpirtëror në liri dhe dinjitet, në kushtet e sigurise ekonomike dhe me mundësi të barabarta,

Duke patur parasysh veç asaj, se diskriminimi përbën një shkelje të të drejtave të përmendura në Deklaraten Universale të të Drejtave të Njeriut,

Miraton, sot, me 25 qershor 1958, Konventën e mëposhtme, e cila do të quhet Konventa mbi Diskriminimin (punësimi dhe profesioni), 1958.

Neni 1

1. Në këtë Konventë termi "diskriminim" përfshin:

- a) Çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinen sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit,
- b) Çdo dallim tjetër, përjashtim, ose preferencë që çon në prishjen apo shtrëmbërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit, qe mund të specifikohet nga një Anëtar i interesuar pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, nëse këto ekzistojnë, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

2. Dallimet, përjashtimet ose preferencat e mbështetura në kualifikimet që kërkohen për një vend punë të caktuar nuk konsiderohen diskriminim.

3. Në këtë Konventë fjalët "vend punë" dhe "profesion" përfshijnë mundësinë për kualifikim profesional, për të hyrë në punë dhe për të punuar në profesione të ndryshme, si dhe kushtet e punësimit.

Neni 2

Çdo Anëtar, për të cilin kjo Konventë është në fuqi, zotohet të formulojë dhe të zbatojë një politikë kombëtare që synon të nxitë me metoda të pershtatura rrethanave dhe realitetit kombëtar, realizimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në drejtim të punësimit dhe të profesionit, me qëllim që të eliminojë keshtu çdo diskriminim në këtë fushë .

Neni 3

Çdo Anëtar, për të cilin kjo Konventë është në fuqi, duhet që me metoda përshtatur rredhanave dhe realitetit kombëtar:

- a) Të përpiqet të sigurojë bashkëpunimin e organizatave të punëdhënësve e të punonjësve, si dhe të organeve të tjera të përshtatshme, për të favorizuar pranimin dhe zbatimin e kësaj politike;
- b) Të nxjerrë ligje dhe të inkurajojë programe arsimore të aftë të sigurojnë këtë pranim dhe këtë zbatim;
- c) Të anullojë çdo dispozitë legjislative dhe të ndryshojë çdo dispozitë apo praktikë administrative që janë të papajtueshme me politikën në fjalë;
- d) Të zbatojë këtë politikë në drejtim të vendeve të punës që ndodhen nën kontrollin e drejtëpërdrejtë të një autoriteti kombëtar .
- e) Të sigurojë zbatimin e kësaj politike në aktivitetet e strukturave të orientimit profesional, të përgatitjes profesionale dhe të punësimit që i nënshtrohen kontrollit të një autoriteti kombëtar;
- f) Të tregojë, në raportet e veta vjetore mbi zbatimin e Konventës, masat e mara në përputhje me këtë politikë dhe rezultatet e arritura .

Neni 4

Nuk konsiderohen diskriminim të gjitha ato masa që prekin një individ për të cilin dyshohet me të drejtë se kryen një aktivitet të dëmshëm për sigurimin e Shtetit apo provohet se me të vërtetë e zhvillon këtë

aktivitet, por me kusht që ky person të ketë të drejtën t'i drejtohet një instance kompetente që është krijuar sipas praktikës kombëtare .

Neni 5

1. Masat e posaçme të mbrojtjes apo të ndihmës të parashikuara në konventa të tjera apo në rekomandimet e miratuara nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës nuk konsiderohen diskriminim.
2. Çdo Anëtar mundet, pasi të jetë konsultuar me organizata përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, të përcaktojë si jo diskriminuese të gjitha masat e tjera të posaçme që synojnë të mbajnë parasysh nevojat e veçanta të atyre personave, të cilëve, në përgjithësi, kjo i njihet si e nevojshme për arsye seksi, moshe, invaliditeti ose të nivelit social e kulturor, si dhe për shkak të ngarkesës familjare .

Neni 6

Çdo Anëtar që e ratifikon këtë Konventë zotohet ta zbatojë atë në territoret jo metropolitane, në përpudhje me dispozitat e Kushtetutes së Organizatës Ndërkombëtare të Punës .

Neni 7

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente do t'i njoftohen Drejtorit të Përgjithshme të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, i cili i regjistron ato.

Neni 8

1. Kjo Konventë lidh vetëm Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i të cileve është regjistruar paraprakisht nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Ajo do të hyjë në fuqi për çdo Anëtarë dymbëdhjetë muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit nga ana e tij.

Neni 9

1. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë në mbarim të një periudhe 10-vjeçare pas datës që ka hyrë fillimisht në fuqi Konventa, përmes një akti që i njoftohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe regjistrohet prej këtij. Denoncimi do të marrë efekt vetëm pas një viti nga dita e regjistrimit të tij.
2. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që, brenda afatit njëvjeçar pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në

paragrafin paraardhës, nuk e përdor të drejtën e denoncimit që parashikohet nga ky nen, do të lidhet për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe, rrjedhimisht, mund ta denoncojë këtë Konventë në kohën e mbarimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare në kushtet e parashikuara në këtë nen .

Neni 10

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do të njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që do t'i mbërrijnë nga Anëtarët e Organizatës. Duke njoftuar Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që do t'i ketë mbërritur, Drejtori i Përgjithshëm do të terheqë vëmendjen e Anëtareve të Organizatës lidhur me datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të punës do t'i dergojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për efekt regjistrimi, sipas Nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, informacione të plota lidhur me të gjitha ratifikimet dhe të gjitha aktet e denoncimit që do të regjistrojë në përputhje me nenet paraardhëse.

Neni 12

Sa herë që do ta gjykojë të arsyeshme, Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë nëse duhet futur në rendin e ditës të Konferencës çështja e rishikimit të saj të plotë ose të pjesshëm.

Neni 13

1. Nëse Konferenca do të miratonte një Konventë të re do të rishikonte tërësisht ose pjesërisht këtë Konventë dhe në rast se Konventa e re nuk vendos ndryshe:

Ratifikimi, nga një Anëtar, i Konventës së re që bën rishikimin, do të shkaktonte vetvetiu, megjithë nenin 9 të mësipërm, denoncimin e menjehershëm të kësaj Konvente, por me kusht që konventa që përmban rishikimin të ketë hyrë në fuqi,

b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të konventës së re që

përmban rishikimin, kjo Konventë do të pushojë së qëni e hapur për ratifikimin e Anëtarëve.

2. Kjo Konventë gjithësesi do të qëndrojë në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e tanishtme për Anëtarët që e kanë ratifikuar dhe që nuk do të ratifikonin konventën që përmban rishikimin.

Neni 14

Versionet frëngjisht dhe anglisht të tekstit të kësaj Konvente janë njësoj te besueshëm.

Teksti i mësipërm është teksti autentik i Konventës që është miratuar në formë të rregullt nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e saj të dyzetë e dytë që zhvilloi punimet në Gjenevë dhe u deklarua e mbyllur me 26 qeshor 1958.

Duke u bazuar në sa më sipër, u vunë nënshkrimet, sot me 5 korrik 1958.